



KONTRATË

ME DATË 03.12.2021 NË MES TË:

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga:UÇK,nr.2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

" Nuhi Azemi", Dumnic e Poshtëme- Podujevë, përfaqësuar nga Nuhi Azemi –Drejtor ` , me numër të regjistrimit të biznesit nr. 810786189 në tekstin e mëtejme ("Kryesi i puneve"), janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për punët të shënuara me poshtë:

"Renovimi i shtëpisë së djegur në Lebanë"

616 21 155 536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Renovimi i shtëpisë së djegur në Lebanë.**

1.2 Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: : 8 350,00€(Tetë mijë e treqind e pesëdhjet euro e zero euro cent)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj pas përfundimit të të gjitha punëve pas konststaimit të mengjerit dhe ekipit mbikqyres të caktuar nga Autoriteti Kontraktues.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [punëve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [furnizimeve] [shërbimeve] [punëve].

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Zekë Bardhaj	Emri:	
Pozita:	Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit	Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	03.12.2024	Data:	
Vula:		Vula:	

Paramasa dhe Paralogaria për shtëpinë e djegur në Lebanë

Vërejtje: Të bëhen verifikimet dhe matjet e hapësirës .Për ngjyra dhe tekstura të konsultohet paraprakisht organi mbikëqyrës.

A PUNËT E RENOVIMIT					
nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Shuma
1	Demolimi i dyshemesë ekzistuese (pllaka keramike, linoleum, laminat, shtresë plastike, tepison etj.) dhe bartja e materialit deri në deponi. Pozicioni përfshinë punët deri në pregaditjen e dyshemesë për estrih.	m ²	45	€ 1.00	45.00 €
2	Gërryerja e mureve ekzistuese dhe plafonit (Ilaçit të suvatimit).	m ²	160	€ 0.80	128.00 €
3	Demolimi i mureve të katit 1 dhe mbetjeve të shkaktuara nga zjarri (trare druri gjysëm të djegura, tjegulla, mure të dëmtuara etj.) dhe largimi i tyre deri në deponinë e përcaktuar nga organet kompetente. Ky pozicion përfshinë punët deri në pastrimin në tërësi të pllakës dhe pregaditjes për punimin e kulmit të ri në pllakën mbi përdhesë.	m ²	60	€ 2.00	120.00 €
4	Furnizimi me material dhe punimi i kulmit 4 ujqorë. Dimensionet e përgjithshme të kulmit janë 13.5m' dhe 5m'. Në pozicion përfshihen trajet dhe shtyllat e drurit, listellat, gozhdat, dërrasat me trashësi t=1.5cm, tjegullat, kulmarët, ullukët dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për finalizimin dhe funksionalizimin e këtij pozicioni.	m ²	66	€ 42.00	2,772.00 €
5	Izolimi me material të ftohtë (kundër lagështisë) në dysheme dhe mure.	m ²	80	€ 2.00	160.00 €
6	Suvatimi i mureve dhe plafonit prej fazës së parë e deri në finalizim (spërkatje me çimento të lëngshme, Ilaç suvaje, masë rrafshuese,glet). Në pozicion përfshihen këndoret, shpaletat rrjeta dhe të gjitha materialet përcjellëse për finalizimin dhe funksionalizimin e pozicionit.	m ²	160	€ 2.00	320.00 €
7	Furnizimi me material dhe punimi i estrihut me trashësi të përgjithshme t=9cm. Në pozicion përfshihet shtresa e termoizolimit t=3cm dhe 6cm estrih. Estrihu duhet të jetë i gatshëm për vendosjen e pllakave të keramikës.	m ²	45	€ 10.00	450.00 €

8	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të keramikës në dysheme. Në pozicion përfshihet edhe vendosja e cokllave nga l njehti material l keramikës së dyshemesë, ngjitësi l kualitetit të lartë, fuga etj.	m ²	45	€	15.00	675.00 €
9	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të keramikës në mure. Në pozicion përfshihet edhe vendosja e cokllave nga l njehti material l keramikës së dyshemesë, ngjitësi l kualitetit të lartë, fuga etj.	m ²	20	€	15.00	300.00 €
16	Furnizimi me material dhe instalimi l ri l rrjetit elektrik në hapësiren prej 45 m ² ku përfshihen: 3 siguresat kryesore (fidi), kutia shpërndarëse (10 siguresa), kabllimi afërsisht 150 m', priza rreth 8 copë, ndërprerës rreth 5 copë, 5 poça elektrik me pajisje përcjellëse. Në pozicion përfshihen të gjitha pajisjet përcjellëse për finalizimin dhe funksionalizimin e këtij pozicioni.	paushall	1	€	100.00	100.00 €
17	Furnizimi me material dhe instalimi l rrjetit të ri të ujit dhe kanalizimit. Në pozicion përfshihen gypi kryesor për furnizim PVC ø25 rreth 10m', kutia shpërndarëse me 6 ventila, gypat për shpërndarje PVC ø18 rreth 25m'. Në pozicion përfshihen mbajtëset e kokave, ventilave dhe të gjitha pjesët përcjellëse për finalizimin dhe funksionalizimin e pozicionit.	paushall	1	€	100.00	100.00 €
21	Furnizimi me material dhe vendosja e dritareve me dimensione 90cm x 140cm, xham 2 shtresor. Materiali PVC.	copë	3	€	150.00	450.00 €
Nëntotal A						5,620.00 €

B	PUNËT E INVENTARIT					
10	Tepih me dimensione të përafërta 1.8cm x 2.5cm	copë	2	€	50.00	100.00 €
11	Kuzhinë me dimensione l=230cm. Duhet të përmbajnë lavabo, çezme, frigorifer, shporet (pllakë dhe furrë) dhe aspirator.	copë	1	€	800.00	800.00 €
12	Shporet për ngrohje me dru. Në pozicion përfshihen pajisjet përcjellësi si: gypat e tymit, bërrylat, lidhëset etj.	copë	1	€	80.00	80.00 €
13	Ulëse për 3 persona. Materiali shtof.	copë	1	€	100.00	100.00 €

14	Shtrat me dimensione 180cm x 200cm. Në pozicion përfshihet korniza e shtratit, rami, jogi etj.	copë	1	€ 200.00	200.00 €
15	Orman për tesha. Dimensionet e përgjithshme 180cm x 60cm dhe h=200cm. Materiali pllakë zdrukthi melaminë.	copë	1	€ 300.00	300.00 €
	Tavolinë për qëndrim ditor. Dimensionet 50cm x 50 cm.	copë	1	€ 50.00	50.00 €
18	Furnizimi me material dhe vendosja e pajisjeve sanitare: Dushi, ëc guaca, lavamani, çeshmja, pasqyra.	paushall	1	€ 300.00	300.00 €
19	Furnizimi me material dhe vendosja e dyerve MDF. dimensione 90cm x 210 cm.	copë	2	€ 150.00	300.00 €
20	Furnizimi me material dhe vendosja e derës hyrëse PVC. dimensione 90cm x 210 cm.	copë	1	€ 500.00	500.00 €
Nëntotal B					2,730.00 €

RIKAPITULLIM		
A	PUNËT E RENOVIMIT	5,620.00 €
B	PUNËT E INVENTARIT	2,730.00 €
Total:		8,350.00 €

Deklaratë e garantuesit

**GARANCI KONTRATE
POLICA NR. 070010460006005**

Për: KOMUNA E PRISHTINES
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: Nuhi Azemi B.I. - N.N. " Nuha "
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: RENOVIMI I SHTEPISE SE DJEGUR NE LEBANE

Numri i Prokurimit: 616-21-8119-5-3-6 NR I BRENDSEHEM 616 21 155 536

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitohet sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtënjshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 1,000.00 € Nje mije Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 1,000.00 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 02.02.2022



Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Luan Haradinaj Llamella A, Prishtine

Data: 03.12.2021